



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr. 3556/8 prot

Datë, 23/07 /2018

VENDIM

Nr. 16 Datë 12/02 /2018

PËR
MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR (PUSHPIM), NË AUTOSTRADË TIRANË KM 3, MËZES, NJËSIA ADMINISTRATIVE KASHAR TIRANË SUBJEKTI "PORSCHE ALBANIA" PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE, SANITARE

Në zbatim të Ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" Përkatësisht N.41 pika 1 gërma "e" N.50 pika 2; Vendimin Nr. 416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" Neni 7 pika 3, Vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor" neni 11 pika 3.

VENDOSI:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorimin e burimit ujor, për qëllime sanitare për subjektin "Porsche Albania" shpk me administrator Gentian Bushati, vendndodhja autostrada Tiranë-Durrës km 3, Mëzes, njësia administrative Kashar, Tiranë me këto të dhëna .

- Koordinatat: X= 45 80 230 Y=43 96 300 Z=65.2 m
- Kapaciteti i pusit 0.003 m³/s (3 l/s)
- Thellësia e pusit 30 m
- Volumi maksimal që kërkohet 0.001 m³/s (1l/s)
- Sasia e e ujit që jepet për përdorim 0.001 m³/s (1l/s)
- Qëllimi i përdorimit Teknologjik, sanitar
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur

2.Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3.Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Dorina ÇAPUNI



KRYETAR
Suzana JAHOLLARI

